



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1652/ 7 prot.

Datë 23.06.2026

V E N D I M
Nr. 852 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23 .06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “HEST ” shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81328-04-08-2026, me objekt “Materiale elektrike”, me fond limit 1 416 575 (Një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike.

Ankimues:

Operatori ekonomik “HEST ” sh.p.k, me Nipt, L21527009H, me adresë: Tirane /Mezes Nr 440/124 Zk 2679 volumi 14.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, me adresë: L. Tre Heronjte, Rr. Marin Biçikemi, Shkodër, Dpmop@bashkiashkoder.gov.al

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të

Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 09-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81328-04-08-2026, me objekt “Materiale elektrike”, me fond limit 1 416 575 (Një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike.

II.2 Në datën 22.05.2026 autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "HEST"	1 062 560	lekë skualifikuar
2. "3E COMPLEX"	1 100 000	lekë skualifikuar
3. "ITE GROUP"	1 129 780	lekë skualifikuar
4. "KEJ Group"	1 205 130	lekë kualifikuar
5. "M U R A T I"	1 256 200	lekë skualifikuar
6. "ERVIN LUZI" pf	1 313 575	lekë skualifikuar
7. "DELIA IMPEX"	0	lekë skualifikuar

II.3 Në datën 25.05.2026 autoriteti kontraktor ka bërë publikimin e njoftim fituesit paraparak të procedurë së prokurimit në SPE .

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2026/ 6725, datë 26.05.2026 dhe me Nr.1652/2026 Prot., datë 26.05.2026 e operatorit ekonomik "HEST" shpk duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi Skualifikimin e ofertës së tij.

II.5 Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprahe" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1652/1 prot., datë 28.05.2026, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e pretendimeve të tij .

II.6 Më datë 01.06.2026 me shkresën 461 prot datë 29.05.2026 Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike, ka përcjellë shkresën me nr.1652/1, datë 01.05.2026, me objekt "*Kthim përgjigje* ", në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik , për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar këtë të fundit.

II. 7 Me shkresën nr. 1652/3 datë 02.06.2026 KPP i është drejtuar AK me kërkesë për dorëzimin e mostrave .

II.8 Me shkresën nr. 1652/4 datë 05.06.2026 AK me kërkesë ka përcjellë pranë KPP informacionin e kërkuar për dorëzimin e mostrave .

II.9 Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me arsyen e skualifikimit te operatorit ekonomik ankimues “Hest ” shpk, si në vijim:

- [KVO ka bërë një vlerësim jo të drejtë duke mos vlerësuar ofertën më të mirë ekonomike të HEST sh.p.k me vlere 1,062,560 (Një Milion e Gjashtëdhjetë e Dy Mijë e Pesëqind e Gjashtëdhjetë) ; Lekë dhe duke i shkaktuar dëm ekonomik i cili dëmton tërthorazi interesin publik duke shpallur fitues OE, i cili është i renditur i pesti dhe me vlerë 1,205,130 (Një milion e Dyqind e Pesë mijë e një qind e tridhjetë)Leke pa tvsh → Më poshtë po japim specifikimet e AK sic janë paraqitur në DST Autoriteti Kontraktor në Dokumentat standarde ka vendosur specifikime teknike për produktet dhe ndër to kemi: 1.Pllafone 60x60 me këto specifikime : Përmasat: 60 x 60 cm. Tensioni: 220-240V. Ndriçim me ngjyrë të bardhë, 4000 Kelvin. Instalohet lehtësisht në mur ose tavane prej gipsi 2. Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40; Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40 Gjithashtu AK ka kërkuar: 2.3.5 Operatori ekonomik ofertues ditën e hapjes se ofertave duhet te paraqese mostrat per artikujt si me poshte. Mos paraqitja e mostrave prane Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike ose mos perputhja e tyre me specifikimet teknike te publikuara perben kusht per skualifikim. → Argumentat Hest shpk ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, skedat teknike ku percaktohen të dhënat e produktit, si dhe prezantimin e produkteve sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor . Produkti 1. 1.Pllafone 60x60 me këto specifikime : Përmasat: 60 x 60 cm. Tensioni: Ndriçim me ngjyrë të bardhë, 4200 -Kelvin. 220-240V. Argument: KVO ka shprehur ‘pllafone 60x60 “me ngjyrë të bardhë’. Hest shpk ka ruajtur të gjitha sepcifikimet e kërkuara si Ëat, Volt, përmasa dhe kalvin 4200 për më mirë. KVO pretendon se nuk është e pranueshme 4200 K, por kjo nuk përbën arsye skualifikimi pasi sipas standarde ndërkombëtare kjo nuk përbën disavantazh sepse me kalimin e kohes bie niveli i ndricimit dhe 4200 është më mirë sesa kërkohet. Ndryshimi midis 4000 dhe 4200 është minimal dhe ky ndryshim është i pa përfillshëm si në ngjyrën e temperaturës së ndricimit që në të dyja rastet është i bardhë . Për këtë detaj jemi konsultuar me ekspertë të fushës, por edhe në kërkime shkencore të dyja K4000 dhe K4200 janë të bardha. Sipas ligjit LPP nenit 36 AK nuk mund të refuzojë ofertën më të përshtatshme që përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. Neni si më poshtë. Kjo specifikë e refuzimit nuk qëndron! Produkti 2 2. Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40; Argument: KVO ka kërkuar mostër Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40 (kërkesat e DST janë bërë copy paste nga DST dhe janë paraqitur më lart). Hest shpk ka paraqitur moster të tubit, pra sic kërkohet në DST. KVO shprehet që mungon fija, por nuk është e vërtetë, pasi mostra është një demostrim dhe nuk kemi dërguar gjithë bobinën që KVO të shohi filispanjën, por nëse ishin të kujdesshëm në marrjen e vendimit duhet të kishin ballafaquar tubin me specifikimet te skeda teknike e paraqitur nga HEST shpk, ku shprehen të gjitha detajet si dhe filispanja . Në DST nuk është specifikuar të sillet e gjithë bobina që të shihnin filispanjën Ø 40. Edhe ky argument nuk qëndron! Shpresojmë që argumentat të jenë të qartë dhe sipas LPP LIGJI NR. 162 DATE 23.12.2020 PER PROKURIMIN PUBLIK Neni 36 Pika 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në

rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.], Komisioni prokurimit publik vë re se,

III.1.1 Autoriteti kontraktor në shtojcën 6 “Specifikimet teknike” si dhe në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues ditën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat për artikujt si më poshtë. Mos paraqitja e mostrave prane Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike ose mos përputhja e tyre me specifikimet teknike të publikuara perben kusht për skualifikim.*

Nr	Emërtimi i Materialit	Njësia	Sasia
1	Automat diferencial (salvavide) 63A 4modulare	Copë	1
2	Automat diferencial (salvavide) 40A 4modulare	Copë	1
3	Automat 63A 4 modular	Copë	1
4	Automat 40A 4 modular	Copë	1
5	Llambe sinjalizimi per tensionin	Copë	1
6	Kuti automati, 36M	Copë	1
7	Pllafone 60x60	Copë	1
8	Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40	ml	1

- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.*
- *Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 6. Formulari i specifikimeve teknike

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, në zbatim të Rregjistrimit të Parashikimit të Prokurimeve Publike të Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike për vitin 2026, nisi punën për hartimin e specifikimeve teknike të nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit publik me objekt **“Blerje Materiale Elektrike”**.

Specifikimet Teknike

Nr	Lloji I mallit	Specifikimet teknike
1	<i>Automat diferencial (salvavide) 63A 4modulare</i>	Fuqia max: 4.5kA Materiali: baker/ Plastik Shkalla e mbrojtjes: IP20 Tensioni: 230V
2	<i>Automat diferencial (salvavide) 40A 4modulare</i>	Fuqia max: 4.5kA Materiali: baker/ Plastik Shkalla e mbrojtjes: IP20 Tensioni: 230V
3	<i>Automat 63A 4 modular</i>	Rryma: 63A Gjerësia: 70 Klasi: C Numri i moduleve: 4 Tensioni: 400V Thellësia: 69
4	<i>Automat 40A 4 modular</i>	Rryma: 40A Gjerësia: 70 Klasi: C Numri i moduleve: 4 Tensioni: 400V Thellësia: 69
5	<i>Automat 10A</i>	Rryma: 10A Gjerësia: 35 Klasi: C Numri i moduleve: 2 Tensioni: 230V Thellësia: 69
6	<i>Automat 16A</i>	Rryma: 16A Gjerësia: 35 Klasi: C Numri i moduleve: 2 Tensioni: 230V Thellësia: 69
7	<i>Automat 20A 2 polar</i>	Rryma: 20A Gjerësia: 35 Klasi: C Numri i moduleve: 2 Tensioni: 230V Thellësia: 69

8	<i>Automat 25A 2 polar</i>	Rryma: 25A Gjerësia: 35 Klasi: C Numri i moduleve: 2 Tensioni: 230V Thellësia: 69
9	<i>Shirita bakri te dhembezuar per automate</i>	Materiali: baker Modeli: 12 module Shkalla e mbrojtjes: IP20
10	<i>Llambe sinjalizimi per tensionin</i>	Gjatësia: 6.5cm Gjerësia: 1.7cm Tipi: Llambë sinjali
11	<i>Kuti automati brenda murit</i>	Materiali: plastik Ngjyra: e bardhe/zeze Numri i moduleve: 24M
12	<i>Kuti automati, 36M</i>	Materiali: plastik Ngjyra: e bardhe/zeze Numri i moduleve: 36M
13	<i>Priza shuko</i>	Rryma: 16 A Tipi: Prizë shuko universale Materiali: Metal / plastik Ngjyra: E bardhë Numri i moduleve: 2 Tensioni: 220-240 V
14	<i>Celes i thjeshte 1 Modular</i>	Fuqia: 10 A Materiali: plastik Numri i moduleve: 1 Modul Tensioni: 220-240 V
15	<i>Tapa falso 1M</i>	Gjatësia: 4.3cm Gjerësia: 2.1cm Tipi: Tapë falso Materiali: Plastik Ngjyra: bardhe Numri i moduleve: 1 Thellësia: 2.2cm
16	<i>Support 3 modular</i>	Aksesorët e përfshirë: Vidat Tipi: Suport Materiali: Plastik Numri i moduleve: 3
17	<i>Kapak 3M</i>	Materiali: Plastik Ngjyra: e bardhe
18	<i>Kutija jashte murit 2 vendesh</i>	Tipi: Kuti 2 Modulare e jashtme muri Materiali: Plastik Ngjyra: Gri Numri i moduleve: 2

19	<i>Kutija jashte murit 1 vendesh</i>	<i>Tipi: Kuti 1Modulare e jashtme muri</i> <i>Materiali: Plastik</i> <i>Ngjyra: Gri</i> <i>Numri i moduleve: 1</i>
20	<i>Kanaline 22x22</i>	<i>Gjatësia: 2000 mm</i> <i>Gjerësia: 22 mm</i> <i>Lartësia: 22 mm</i> <i>Tipi: Kanaline</i> <i>Materiali: Plastike</i> <i>Modeli: Ngjitje</i> <i>Ngjyra: E bardhe</i>
21	<i>Kapak PT9</i>	<i>Përmasat totale:479x154x70</i>
22	<i>Kapak PT10</i>	<i>Përmasat totale: 480 x 160 x 75 mm</i>
23	<i>Morsete 16mm 75A (steke10)</i>	<i>Materiali: Baker/Plastik</i> <i>Seksioni: 16mm</i> <i>Tensioni: 230V</i>
24	<i>Morsete 10mm 60A (steke10)</i>	<i>Materiali: Baker/Plastik</i> <i>Seksioni: 10mm</i> <i>Tensioni: 230V</i>
25	<i>Morsete 6mm 32A (steke10)</i>	<i>Materiali: Baker/Plastik</i> <i>Seksioni: 6mm</i> <i>Tensioni: 230V</i>
26	<i>Pllafone 60x60</i>	<i>Përmasat: 60 x 60 cm.</i> <i>Tensioni: 220-240V.</i> <i>Ndriçim me ngjyrë të bardhë, 4000 Kelvin.</i> <i>Instalohet lehtësisht në mur ose tavane prej gipsi</i>
28	<i>Kabull 4x25</i>	<i>Tipi: Percjelles Bakri</i>
29	<i>Percjelles elektrik 1x2.5</i>	<i>Tipi: Percjelles elektrike</i> <i>Materiali i izolimit: PVCR2</i> <i>Ngjyra: Blu</i> <i>Paketimi: 100m</i> <i>Temperatura e punës: +5°C - +60° C</i> <i>Tensioni: N07VK-K 240</i>
30	<i>Percjelles elektrik 1x6</i>	<i>Tipi: Percjelles elektrike</i> <i>Materiali i izolimit: PVCR2</i> <i>Ngjyra: Kafe</i> <i>Paketimi: 100m</i> <i>Temperatura e punës: +5°C - +60° C</i> <i>Tensioni: N07VK-K 240V</i>

31	<i>Percjelles 1x10</i>	<i>Tipi: Percjelles elektrike</i> <i>Materiali i izolimit: PVC R2</i> <i>Ngjyra: Jeshile/verdhe</i> <i>Paketimi: 100m</i> <i>Temperatura e punës: +5°C - +60° C</i> <i>Tensioni: N07VK-K 240V</i>
32	<i>Izolant elektrik</i>	<i>Gjatësia totale: 10 m</i> <i>Gjerësia: 18 mm</i> <i>Paketimi 10cope</i>
33	<i>Upi+vida Ø8</i>	<i>Paketimi 20 cope (perfshi vidat)</i>
34	<i>Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40</i>	<i>Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40</i>

III.1.2 Në përmbushje të kriterit 2.3.5 operatori ekonomik “Hest” shpk, ka depozituar në autoritetin kontraktor mostrat e kërkuara në kriterin e sipërcituar, mostra të cilat janë përcjellë nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të prokurimit publik me shkresën nr. 486 prot datë 04.06.2026 protokolluar me tonën 1652/4 datë 05.06.2026.

III.1.3 Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.1. 6. Në nenin 2 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; 40 dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 21 pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.1.7. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht si vijon: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.8. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit

administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë 13 pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.1.10. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, kemi kriterin 2.3.5 të DT, sipas së cilit “Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për mallrat objekt prokurimi me numer rendor 26 (referoju artikujve sipas shtojcës 6). Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike dhe cilësisë që ato duhet të kenë. Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor (Vendimi i KSHA me nr. 461 prot datë 29.05.2026), KPP gjykon se, autoriteti kontraktor ka skualifikuar me pa të drejtë operatorin

ekonomik “HEST” ShPK, pasi mostra e paraqitur prej tij, është në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, komponentët e kërkuar, janë sipas specifikimeve teknike të shtojcën nr.6 “formulari i specifikimeve teknike” për artikullin me nr.rendor 26 , “Pllafone 60x60” Përmasat: 60 x 60 cm. Tensioni: 220-240V. Ndriçim me ngjyrë të bardhë, 4000 Kelvin.Instalohet lehtësisht në mur ose tavane prej gipsi, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Referuar mostrës së paraqitur të ankimuesit në autoritet kontraktor si dhe specifikimeve teknike të këtij artikulli në SPE, konstatohet se, është kërkuar 4000 Kelvin, pas verifikimeve rezulton se mostra përveçse është në përmbushje të specifikimeve teknike të parashikuara , e tejkalon në 4200 Kelvin. Në rastin konkret, Komisioni referuar informacionit të dërguar nga autoriteti si dhe pas verifikimit të mostrës për artikullin me nr. 26 “Pllafone 60x60, konsiderohet se është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.

Lidhur me pretendimin për artikullin nr. “36 Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40” Në rastin konkret, në kriterin 2.3.5 të DT, sipas së cilit “Në menyre që të krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik duhet të paraqese mostra për mallrat objekt prokurimi me numer rendor 34 (referoju artikujve sipas shtojcës 6). Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike dhe cilësisë që ato duhet të kenë. Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor (Vendimi i KSHA me nr. 461 prot datë 29.05.2026), KPP gjykon se, autoriteti kontraktor me të drejtë e ka skualifikuar operatorin ekonomik “HEST” ShPK, pasi mostra e paraqitur prej tij, nuk është në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, komponentët e kërkuar, janë sipas specifikimeve teknike të shtojcën nr.6 “Formulari i specifikimeve teknike” për artikullin me nr.rendor 34 , “Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Referuar mostrës së paraqitur të ankimuesit në autoritet kontraktor si dhe specifikimeve teknike të këtij artikulli në SPE, konstatohet se, është kërkuar “Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40”, pas verifikimeve rezulton se mostra nuk është në përmbushje të specifikimeve teknike të parashikuara. Në rastin konkret, Komisioni referuar informacionit të dërguar nga autoriteti si dhe pas verifikimit të mostrës për artikullin me nr.34 “Tub elektrik korregato me filispaje Ø 40”, konsiderohet se nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Hest ” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81328-04-08-2026, me objekt “Materiale elektrike”, me fond limit 1 416 575 (Një milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 21.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve të njoftojë Komisionit të Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori “Hest” shpk.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro

